

VENDIM
Nr. 181, datë 23.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 104, DATË 23.6.2016, TË BORDIT TË ERE-s, “MBI PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME, SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s NR. 49, DATË 21.10.2004 DHE NR. 146, DATË 24.12.2013”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, me nr. 96, datë 17. 6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23/11/2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104 të Bordit të ERE-s, datë 23.6.2016, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013,

konstatoi:

- Bazuar në nenet 16 dhe 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s ka miratuar vendimin nr. 104, datë 23.6.2016,

- Në shkresën me nr. 800 prot., datë 14.10.2016, drejtuar kompanisë “OSHEE” sh.a., ERE ka parashtruar problematikat e disa klientëve të energjisë elektrike lidhur me faturimin nën zërin “konsum aktiv vlerë referuese” për muajin gusht 2016.

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 24869 prot., datë 27.10.2016, protokolluar me tonën me nr. 495/1 prot., datë 28.10.2016 ka paraqitur në ERE një kërkesë për interpretim.

- ERE ka organizuar një seancë dëgjimore më datë 14.11.2016, mes përfaqësuesve të shoqërisë “OSHEE” sh.a. dhe ERE me qëllim interpretimin e vendimit nr. 104 të Bordit të ERE-s, datë 23.6.2016 “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

- Nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a. janë bërë me dije një sërë problematikash lidhur me zbatueshmërinë nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a., të vendimit nr. 104 të Bordit të ERE-s, datë 23.6.2016, për kontratat e furnizimit të energjisë elektrike që nuk kanë një historik faturimi, për konsumin me matje të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

2. Pika 2 e vendimit nr. 104, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, ndryshohet si vijon:

- a) “Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesit në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë

elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përlogaritet bazuar në mesataren aritmetike të faturimeve me matje përgjatë 3 viteve të mëparshme, të të njëjtit muaj me atë të faturuar.

Periodha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.”

b) “Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

c) Për kontratat e furnizimit me energji elektrike me matës të energjisë elektrike të instaluar në boks kolektiv, përjashtohet faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes.”

ç) “Për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë së faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti